

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-81 EpoCem®

LLAÇ ÇIMENTOJE I MODIFIKUAR ME EPOKSID, ME 3 PËRBËRËS DHE I VETËNIVELUESHËM PËR SHTRESA DYSHEMEJE NGA 1.5 DERI NË 3 MM.



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-81 EpoCem® është llaç me 3 përbërës, me bazë çimentoje, i modifikuar me rrëshira epokside, për shtresa të vetënivelueshme dysHEMEJE në trashësi të holla nga 1.5 deri në 3 mm.

PËRDORIMET

Sikafloor®-81 EpoCem® duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Si barrierë e përkohshme kundër lagështisë (Temporary Moisture Barrier-TMB):

(trashësi min. 2 mm) duke lejuar aplikimin e dysHEMEJE prej rrëshire, poliuretani dhe PMMA* që kërkojnë nënshtresë të thatë, mbi nënshtresë me përmbajtje të lartë lagështie, edhe mbi beton i cili sapo ka fituar rezistencat e tij, për një zgjidhje afatgjatë.

Si llaç i vetënivelueshëm për:

- Nivelim ose meremetim lokal i sipërfaqeve horizontale prej betoni, gjatë punimeve të reja ose meremtimeve, në mjedise agresive kimike
- Veshje dysHEMEJE mbi nënshtresa të lagështa dhe pa ajrosje që nuk kanë kërkesa estetike të veçanta
- Shtresë niveluese poshtë dysHEMEJE / llaçeve epokside, poliuretani, PMMA*, pllakave, moketave ose dysHEMEJE prej druri
- Riparim dhe mirëmbajtje e dysHEMEJE monolite (njëcopëshe) prej betoni

Me shtim rëre kuarci, si llaç për riparime lokale dhe meremtime:

- Poshtë shtresave të dysHEMEJE / llaçeve epokside, poliuretani dhe PMMA

Për përdorim mbi nënshtresa me bazë çimentoje:

- I përshtatshëm për kontroll lagështie (Parimi 2, metoda 2.3, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për rezistencë fizike (Parimi 5, metoda 5.1, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për punime restaurimi (Parimi 3, metoda 3.1, EN 1504-9).
- I përshtatshëm për ruajtje apo restaurim të

pasivitetit (Parimi 7, metoda 7.1 dhe 7.2, EN 1504-9).

- I përshtatshëm për rritje të rezistencës (Parimi 8, metoda 8.3, EN 1504-9)

* Lexo Shënimet mbi aplikimin / Kufizimet

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Mundësi mbiveshjeje me dysHEMEJE me bazë rrëshire pas 24 orësh (+20°C, 75% lagështi relative)
- Parandalon krijimin e flluskave për shkak të fenomenit të osmozës të veshjeve me bazë rrëshire mbi nënshtresa të lagështa
- Aplikim ekonomik, i shpejtë dhe i lehtë
- Kategoria R4, EN 1504-3
- Veti të mira nivelimi
- I papërshkueshëm nga lëngjet, por i përshkueshëm nga avujt e ujit
- Rezistencë ndaj ngricës dhe kripës për shkrirje akulli
- Rezistencë kimike e mirë
- Veti zgjerimi termik të ngjashme me betonin
- Ngjitje e shkëlqyer mbi beton i cili sapo ka fituar rezistencat ose të ngurtësuar, i lagësht ose i thatë
- Rezistenca të shkëlqyera mekanike fillestare dhe përfundimtare
- Rezistencë e shkëlqyer ndaj ujit dhe vajrave
- Përgatitje ideale për sipërfaqe të lëmuar
- Për përdorim të brendshëm
- Pa tretës
- Nuk korrodon armaturën prej çeliku

MIRATIME / STANDARDE

- Raportet ITT për EN 1504-2 Ref. 09/349-963, data 6 maj 2009 dhe EN 1504-3 Ref. 09/351-965 data 4 maj 2009 nga Laboratori Applus, Barcelonë, Spanjë.
- Llaç me bazë çimentoje i modifikuar me epoksid për shtresa të vetënivelueshme dysHEMEJE sipas EN 1504-2: 2004, EN 1504-3: 2005 dhe EN 13813:2002, DoP 02 08 02 01 001 0 000001 1001, certifikuar nga Organi i Kontrollit të Prodhimit në Fabrikë Nr. 2116, mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Llaç me bazë çimentoje i modifikuar me epoksid		
Ambalazhi	Ambalazhe 23 kg		
	Përbërësi A	shishe plastike 1.14 kg	
	Përbërësi B	bidon plastik 2.86 kg	
	Përbërësi C	thes plastik 19 kg	
Paraqitja / Ngjyra	Përbërësi A - rrëshira	lëng i bardhë	
	Përbërësi B - forcuesi	lëng i verdhë transparent	
	Përbërësi C - mbushësi	pluhur gri agregatesh natyrale	
	Ngjyra	gri e lehtë	
	Ngjyra e finiturës	gri mat	
Jetëgjatësia	Përbërësi A, përbërësi B:	12 muaj	
	Përbërësi C:	9 muaj	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C.		
	Përbërësi A, përbërësi B:	Të mbrohet nga ngrica	
	Përbërësi C:	Të mbrohet nga lagështia	
Dendësia	Përbërësi A	~ 1.05 kg/l (në +20°C)	(EN 1015-6)
	Përbërësi B	~ 1.03 kg/l (në +20°C)	
	Rrëshira e përzierë	~ 1.72 kg/l (në +20°C)	
	Përbërësit A+B+C të përzierë:	~ 2.10 kg/l (në +20°C)	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes		+23°C / 50% lagështi relative	(EN 13892-2)
	1 ditë	~15 N/mm ²	
	7 ditë	~50 N/mm ²	
	28 ditë	~60 N/mm ²	
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje		+23°C / 50% lagështi relative	(EN 13892-2)
	1 ditë	~5.8 N/mm ²	
	7 ditë	~11.1 N/mm ²	
	28 ditë	~14 N/mm ²	
Rezistenca ndaj ciklit ngrirje-shkrirje dhe kripërave akullshkrirëse	Faktori i rezistencës WFT-L 98% (i lartë)		D-R (SN / VSS 640 461)
Rezistenca ndaj karbonimit	Rezistenca ndaj karbonimit për trashësi 3 mm: R ≈ 12.5 m		

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Sistemet

Konfigurimi i sistemit siç pëshkruhet më poshtë duhet zbatuar plotësisht dhe nuk duhet ndryshuar.

Prajmeri më poshtë është i përshtatshëm për secilën nga këto nënshtresa:

- Beton i cili sapo ka fituar rezistencat (kur të jetë e mundur përgatitja mekanike)
- Beton i lagësht (moshë > 14 ditë)
- Beton i lagësht i ngurtësuar (lagështi në ngjitje)

Korrigjime dhe riparime:

Trashësi shtrese: 3 – 9 mm

Prajmer: SikaTop®-Armaterc®-110 EpoCem®

Llaçi: Sikafloor®-81 EpoCem® - Përzierje e zgatur miksi. (Lexo Përzierjen për më shumë detaje)

Llaç nivelues për ashpësi mesatare nënshtrese:

Trashësi shtrese: 1.5 - 3 mm

Prajmer: Sikafloor®-155 WN

Llaçi: Sikafloor®-81 EpoCem®

Shtresa përfundimtare: Produkt i përshtatshëm nga seria Sikafloor® dhe Sikagard®.

Lyerje e ndërmjetme me prajmer për Sikafloor -81/82 EpoCem:

Ura lidhëse: Sikafloor®-155 WN

Ju lutemi lexoni skedat teknike të sistemeve:

Sikafloor® MultiDur ES-14 ECC	Llaç epoksid hibrid me teksturë të lehtë dhe bojë epokside me ngjyrë
Sikafloor® MultiDur EB-24 ECC	Sistem dyshemesh epokside me rërë, ngjyrë uniforme mbi barrierën e përkohshme kundër lagështisë
Sikafloor® MultiDur EB-25 ECC	Sistem dyshemesh epokside me rërë, ngjyrë uniforme mbi barrierën e përkohshme kundër lagështisë
Sikafloor® MultiDur ET-14 ECC	Sistem epoksid me teksturë, ngjyrë të njëtrajtshme mbi barrierën e përkohshme kundër lagështisë

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes

Përbërësi A:përbërësi B:përbërësi C - madhësi ambalazhi: 1.14 : 2.86 : 19kg

Llaç për shtrim dyshemeje:

Në temperatura midis +12°C deri në +25°C:

1 : 2.5 : 17 (për peshë)

Përbërësit (A+B) : C = 4 kg : 19 kg

Në temperatura midis +8°C deri në +12°C dhe +25°C deri në +30°C:

Sasia e Përbërësit C mund të reduktohet deri në 18 kg për të përmirësuar punueshmërinë.

Ju lutemi kini parasysh:

Mos reduktoni kurrë Përbërësin C më shumë se kjo sasi.

1 : 2.5 : 15.8 (për peshë)

Përbërësit (A+B) : C = 4 kg : 18 kg

Miksi llaçi me përzierje shtesë / llaç për riparime:

Për riparimin e defekteve / vrimave të sipërfaqes me diametër 3 - 5 cm dhe me thellësi më shumë se 3 mm deri në 9 mm miksi standard Sikafloor®-81 EpoCem® mund të përdoret në kombinim me rërë të thatë kuarci.

Për çdo njësi 23 kg Sikafloor®-81 EpoCem® që është përgatitur siç jepet më poshtë, shtoni:

- Sikadur®-509 (rërë kuarci 0.7 - 1.2 mm) 5 - 10 kg dhe
- Sikadur®-510 (rërë kuarci 2.0 - 3.0 mm) 5 - 10 kg

Miksi përfundimtar do të jetë: 33 - 43 kg

Për këtë aplikim, që të arrihet një ngjitje e mirë e llaçit mbi nënshtresë, duhet të përdoret SikaTop®-Armaterc®-110 EpoCem® si urë lidhëse. Llaçi duhet të aplikohet mbi prajmerin i lagësht mbi të lagësht.

Temperatura e mjedisit

+8°C min. / +30°C max.

Konsumimi

Llaç i vetënivelueshëm:	Sikafloor®-81 EpoCem® ~2.25 kg/m ² /mm
Miks llaçi me përzierje të zgjatur:	Sikafloor®-81 EpoCem® ~2.4 kg/m ² /mm

Ju lutemi referohuni tek skedat teknike të sistemeve:

Sikafloor® MultiDur ES-14 ECC	Sisteme epoksid me teksturë të lehtë për lyerje me ngjyrë mbi barrierën e përkohshme kundër lagështisë (TMB)
Sikafloor® MultiDur EB-24 ECC	Sisteme dyshemesh epokside me spërkatje rëre, ngjyrë të njëtrajtshme mbi barrierën e përkohshme kundër lagështisë (TMB)
Sikafloor® MultiDur EB-25 ECC	Sisteme dyshemesh epokside me spërkatje rëre, ngjyrë të njëtrajtshme mbi barrierën e përkohshme kundër lagështisë (TMB)
Sikafloor® MultiDur ET-14 ECC	Sisteme epoksid me teksturë për lyerje me ngjyrë të njëtrajtshme mbi barrierën e përkohshme kundër lagështisë (TMB)

Këto vlera janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel apo firon, etj.

Trashësia e shtresës	1.5 mm min. / 3.0 mm max. Nëse Sikafloor®-81 EpoCem® përdoret si barrierë e përkohshme kundër lagështisë (Temporary Moisture Barrier, TMB), trashësia e shtresës së aplikuar duhet të jetë min. 2 mm.
-----------------------------	--

Lagështia relative e ajrit	20% min. / 80% max.
-----------------------------------	---------------------

Temperatura e nënshtresës	+8°C min. / +30°C max.
----------------------------------	------------------------

Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	Mund të aplikohet mbi beton të freskët ose mbi beton i cili sapo ka fituar rezistencat, pa prezencë uji të mbledhur. Megjithëse produkti mund të aplikohet mbi beton të freskët (> 24 orë nga shtrimi), këshillohet të prisni të paktën 3 ditë për të shmangur plasaritjet e mundshme nga tkurrja e betonit mbi sipërfaqen e llaçit.
---	---

Koha e punueshmërisë	Temperatura / Lagështi relative	Koha
	75%	
	+10°C	~ 40 minuta
	+20°C	~ 20 minuta
	+30°C	~ 10 minuta

Njësi 23 kg

Koha e maturimit	Sapo Sikafloor®-81 EpoCem® të mos jetë i ngjithshëm në prekje, është i mundur aplikimi i veshjeve izoluese të përkohshme nga avujt. Për aplikimin e veshjeve të papërkohshme nga avujt mbi Sikafloor®-81 EpoCem®, lejoni që lagështia e sipërfaqes të ulet nën 4% dhe jo më herët se:
-------------------------	--

Temperatura e nënshtresës	Koha e pritjes
+10°C	~ 2 ditë
+20°C	~ 1 ditë
+30°C	~ 1 ditë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtresa e betonit duhet të jetë e qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit

(ngjeshjes) (min. 25 N/mm²) me rezistencë min. ndaj tërheqjes 1.5 N/mm².

- Nënshtresa duhet të jetë e lagësht, pa ujë të grumbulluar dhe pa ndotës si vaj, graso, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj. Në rast dyshimi aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

- Nënshtrësas prej betoni duhet të përgatiten mekanikisht me pastrim me rrymë abrazive ose pajisje shkrifërimi për të hequr koren e çimentos (qumësht) dhe për të arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur.
- Betoni i dobët duhet të hiqet dhe defektet e sipërfaqes si p.sh. vrimat/ hapësirat duhet të ekspozohen plotësisht.
- Riparimet mbi nënshtrësë, mbushja e vrimave/ hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes duhet të kryhen duke përdorur produktet e duhura nga seritë e materialeve Sikafloor®, Sikadur® dhe Sikagard®.
- Pluhuri dhe materiali i shpërbërë duhet të hiqet plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë ose vakuum.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes, tundni përbërësin A (lëng i bardhë) derisa të jetë homogjen, pastaj hidheni brenda bidonit të përbërësit B dhe tundeni mirë për të paktën 30 sekonda. Kur dozimi nuk bëhet tek enët, fillimisht përzieni dhe homogjenizoni.

Hidheni miksin lidhës të përzierë (A+B) brenda një ene të përshtatshme për përzierje (me kapacitet rreth 30 litra) dhe shtoni gradualisht përbërësin C tek mikseri ndërsa jeni duke përzierë mekanikisht. Përzieni plotësisht për 3 minuta derisa të arrihet një miksi homogjen pa kokrriza.

Përzieni vetëm njësi të plota të përbërësve A+B+C.

Mos përzieni sasi më të vogla. Mos shtoni ujë.

Në rast se do shtohen agregate të tjera, duhet të shtohen pas hedhjes së përbërësit C tek miksi. Përzieni plotësisht për 3 minuta derisa të përftohet një miksi homogjen.

Veglat e përzierjes:

Përzieni duke përdorur një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300 - 400 rpm) me lopatë helike ose pajisje tjetër të përshtatshme.

Për të përzierje 2-3 hasë menjëherë, rekomandohen miksera me rrotullim tek ose antiorar (lloji me kosh) dhe me veprim të detyruar (lloji me kovë). Nuk duhet të përdoret mikser me rënie të lirë.

APLIKIMI

Aplikoni Sikafloor®-81 EpoCem® e përzierë mbi nënshtrësën e lyster me prajmer dhe përhapeni në mënyrë të njëtrajtshme sipas trashësisë së kërkuar me mallë plastike ose metalike ose me mistri dhe kaloni menjëherë rulin me gjemba për të larguar ajrin e bllokuar dhe për të përfutur një trashësi të njëtrajtshme shtrese.

Punueshmëria mund të adaptohet duke ndryshuar lehtësisht sasinë e përbërësit C.

Mos përdorni ujë shtesë, pasi mund të çrregullojë finiturën e sipërfaqes dhe të shkaktojë çngjyrosje. Mund të arrihet një finiturë pa bashkime nëse gjatë aplikimit nëse skajet e mbaresave ruhen të lagura.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

MIRËMBAJTJA

Për shkak të teksturës së sipërfaqes së tij, Sikafloor®-81 EpoCem® nuk është i përshtatshëm për përdorim si shtresë konsumimi pasi mund të ndodhë me lehtësi njollosje. Këshillohet një veshje izoluese nga seria Sikafloor®, e cila mund të pastrohet me lehtësi. Largoni papastërtitë me furçë dhe/ose vakuum. Mos përdorni metoda pastrimi të lagështa derisa produkti të jetë tharë plotësisht. Mos përdorni metoda abrazive ose detergjente.

DOKUMENTA SHITESË

Cilësia & përgatitja e nënshtrësës

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE".

Udhëzime aplikimi

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE".

KUFIZIME

- Nëse Sikafloor®-81 EpoCem® do të përdoret si TMB (Temporary Moisture Barrier-barrierë e përkohshme kundër lagështisë), duhet të aplikohet një shtresë me trashësi min. 2 mm. (~ 4.5 kg/m²)
- Siguroni gjithmonë ajrosje të mirë kur përdorni Sikafloor®-81 EpoCem® në vende të mbyllura për të larguar lagështinë e tepërt.
- Sikafloor®-81 EpoCem® i aplikuar i freskët duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Parandaloni tharjen e parakohshme duke e mbrojtur nga era e fortë dhe mos e ekspozoni në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor ndërsa është ende i freskët.
- Aplikoni prajmerin dhe Sikafloor®-81 EpoCem® në temperaturë në rënie. Nëse aplikohet gjatë temperaturave në rritje, mund të shfaqen pore të vogla mbi sipërfaqe.
- Duhet të shmangen aplikimet në kushte ekstreme (temperaturë e lartë dhe lagështi e ulët) të cilat shkaktojnë tharjen e shpejtë të produktit, pasi produkti nuk lejon përdorimin e përbërësve për maturim.
- Në asnjë rrethanë nuk duhet të shtohet ujë brenda miksit.
- Mund të ndodhin ndryshime në ngjyrën e Sikafloor®-81 EpoCem® të paizoluara, nëpërmjet ekspozimit të drejtpërdrejtë në rrezatimin diellor. Megjithatë, kjo gjë nuk ndikon negativisht në vetitë mekanike.
- Përpara mbiveshjes me shtresat PMMA, sipërfaqja e Sikafloor®-81 EpoCem® duhet të spërkatet plotësisht me rërë kuarci 0.4 - 0.7 mm.
- Pa përgatitje shtesë, efekti TMB tek Sikafloor® - EpoCem® është i kufizuar në kohë.
- Gjithmonë verifikoni lagështinë e sipërfaqes nëse kanë kaluar më shumë se 5-7 ditë nga aplikimi. Fugat e ndërimit pa lëvizje kërkojnë trajtim paraprak duke aplikuar një shirit me shtresë prajmeri dhe Sikafloor®-81 EpoCem®. Trajtoni si vijon:
 - Plasaritje statike: Mbushini paraprakisht dhe niveloni me rrëshirën epokside Sikadur® ose Sikafloor®.
 - Plasaritje dinamike (> 0.4mm): Duhet të vlerësohen

në kantier dhe nëse nevojitet aplikoni një veshje në formë shiriti me material elastomer ose të projektohet si fugë lëvizjeje.

- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në kohë të reduktuar shërbimi dhe plasaritje reflektive.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja max. e lejuar e VOC (kategori produkti IIA / C lloji wb) është 40 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbajtja max. e Sikafloor®-81 EpoCem® është ≤ 40 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rinas Road, Tirana Business Park

Building nr. 7, 4th floor

Tirana - Albania

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-81 EpoCem®

Qershor 2019, Botimi 01.01

020814010020000001

Sikafloor-81EpoCem-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf

